



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 14.11.2019

(Dokument Parlamentar)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019” NË PARIM

Drejtuar: *Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat*
Seancës Plenare

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjet e tij të datave 7 dhe 12 nëntor 2018, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, në parim.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit në parim të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin: Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zv. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, si dhe specialistë të këtyre tri ministrive.

Ky komision, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2018”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh, se, buxheti i planifikuar për këtë ministri për vitin 2019, i mbulon të gjitha nevojat për programet buxhetore dhe për realizimin e programit politik qeverisës dhe se, ky buxhet, për vitin 2019 parashikohet të jetë 75 miliard e 594 milion e 377 mijë lekë (përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën 13 miliard e 729 milion lekë) ose 4.31% i PBB ose 14.55% përkundrejt buxhetit të shtetit.

Kështu, buxheti i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2019 ka pësuar një rritje në masën 6 % ose në vlerë absolute një rritje prej 4,6 miliard lekë, në krahasim me vitin 2018.

Ndarë ky buxhet në dy fushat e zbatimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Shëndetësinë do të financohen 51 miliard 60 milionë lekë (përfshirë kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes për njësinë e helikopterëve dhe Spitalin Universitar të Traumës) për vitin 2019, ose 2.91% i PBB (2.6% i PBB –së për vitin 2013) ose 9.83% përkundrejt buxhetit të shtetit, për Mbrojtjen Sociale do të financohen 24 miliard 534 milion e 414 mijë lekë ose 1.4% kundrejt PBB.

Me buxhetin e vitit 2019 janë rritur në 20.1% kundrejt buxhetit të vitit 2018 investimet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku peshën më të madhe të kësaj rritje e zënë investimet për shëndetësinë, përkatësisht në kujdesin parësor si dhe atë spitalor në nivel terciar dhe spitalet tona rajonale.

Për vitin 2019, ky buxheti parashikon të financojë mbulimin universal për kontrollin bazë mjekësor për grupmoshën 35 – 70 vjeç, vizitat tek mjeku i familjes, rimbursimin e barnave, vizitat dhe ekzaminimet tek mjeku specialist sipas hallkave të sistemit të referimit për të gjithë popullsinë rezidente në vend; financon një shërbim të urgjencës mjekësore 24/7 në territor të shpejtë, të fuqizuar dhe më të specializuar; parashikon të mbulojë shpenzimet e sistemit parësor dhe atij spitalor: rikonstruksionin tërësor dhe pajisjen e rreth 100 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin me vlerë 300 milion lekë: financon vazhdimin e projektit për modernizimin radikal të QSUT në shërbimet e kirurgjisë së përgjithshme me një vlerë totale investimi 8.52 milion euro dhe ndërtimin e një spitali të ri modern të sëmundjeve të brendshme 14.28 milion euro, si dhe fillimin e punimeve për spitalin modern të pediatriisë me vlerë totale 8 milion euro; do të financojë rikonstruksione, ndërtime të reja dhe kompletim me pajisje mjekësore në disa spitale rajonale si Rikonstruksioni dhe shtesë në Maternitetin e Lezhës, Rikonstruksion dhe shtesë për Maternitetin e Beratit me vlerë 375 milion lekë si dhe do të garantojë përfundimin e investimeve të nisura përgjatë vitit 2018, etj.

Buxheti i vitit 2019 do të financojë, gjithashtu, rritjen e pagave të 18,416 mjekëve dhe infermierëve, nga i cili do të përfitojnë 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë; 4.7 miliard lekë skemën e re të ndihmës ekonomike, e cila garanton eficientë, transparencë, barazi sociale, gjithëpërfshirje duke shmangur abuzivitetin, subjektivizmin dhe alernohet me skemen e punësimit; 15.8 miliard lekë të gjithë skemën e pagesave të personave me aftësi të kufizuara dhe rrjetin e shërbimeve sociale në të gjithë vendin.

Për vitin 2019 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë parashikuar për investime 3,13 miliard lekë ose 525.6 milionë lekë më shumë ose me një rritje prej 20.1% kundrejt investimeve të vitit 2018.

Kujdesi parësor do të vazhdojë zbatimin e Programit Kombëtar për Rehabilitimin e 300 qendrave shëndetësore deri në vitin 2021. Për vitin 2019 janë parashikuar 340 milionë lekë për rikonstruksionin dhe mobilimin me pajisje sipas standardeve për 100 qendra shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë vendin.

Për pjesën që i takon Mbrojtjes Sociale, në prezantimin që bënë përfaqësuesit e kësaj ministrie, u theksua se përkujdesja sociale ka një vend të vecantë në buxhet vjetor.

Ndihma Ekonomike, e cila me reformën e re ka një hapësirë më të madhe buxhetore bashkive, deri në 6% të fondit të mbrojtjes Sociale, i cili mund të përdoret me kriteret e tyre, për të mbrojtur çdo qytetar që nuk përfiton nga kjo skemë, por që realisht është i varfër e ka nevojë për mbështetje nga shteti. Modernizimi i skemës së Ndhmës Ekonomike vijojë me administrimin e regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit, duke arritur që 100% e përfituesve të jenë të përzgjedhur sipas këtij sistemi.

Për personat me aftësi të kufizuar, vënia në zbatim e sistemit të ri të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social është rritur me 4.5% numrin e përfituesve që realisht u takon dhe duke ulur me 10% rastet abuzive. Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020, përfshirë shërbime shëndetësore, sociale, punësimi dhe arsimimi i PAK.

Në buxhetin e vitit 2019, Rehabilitimi i të përndjekurve politikë, perbman shumë prej 1,047 miliard lekë, i cili, në karahasim me vitin 2013, kur në 8 vite të qeverisjes, ishte kompensuar vetëm një kësht për subjektet përfituese të kategorisë parësore dhe një pjesë të trashëgimtarëve, si dhe një pjesë e kështit të dytë për kategorinë parësore, aktualisht, është arritur shpërndarja e kështit të tetë për kategorinë parësore.

Për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, janë planifikuar 887 milion lekë.

Janë 29 qendra sociale ku përfitojnë shërbime 1,082 përfitues që financohen nga buxheti i shtetit nga të cilat 7 janë qendra rezidenciale për të moshuar (269 përfitues), 2 qendra ditore për të moshuar (77 përfitues), 9 qendra rezidenciale për fëmijë (226 fëmijë), 6 qendra rezidenciale zhvillimi (186 fëmijë me aftësi të kufizuar) dhe 2 qendra ditore zhvillimi (99 fëmijë me aftësi të kufizuar), 1 qendër kombëtare për trajtimin e viktimave të dhunës në familje (9 përfitues), 1 qendër kombëtare për trajtimin e viktimave të trafikimit (22 përfitues), 1 qendër kombëtare e emergjencave (50 familje ose 194 përfitues).

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zëvendesministrja e kësaj Ministrie dhe përfaqësuesit e saj, shpjeguan nëpërmjet një informacioni përmbledhës të detajuar mbi buxhetin e Programeve të Punësimit dhe Formimit Profesional për vitin 2019.

U theksua, se, programi i Qeverisë 2017-2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës dhe se punësimi, ka qenë një prioritet i mandatit të parë, e reflektuar kjo në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 – 2020.

Fondet buxhetore për vitin 2019 për arsimin profesional janë 3,3 miliard lekë me një rritje prej 321.5 milion lekë në krahasim me vitin 2018 (10.7%).

Për vitin 2019 buxheti i planifikuar ka rritje në të gjitha zerat e shpenzimeve:

-Në shpenzime korrente buxheti është planifikuar me 49.4 milion lekë më shumë fond i cili është i mjaftueshem për të zhvilluar politikat ekzistuese dhe politikat e reja në fushën e arsimit profesional;

-Është planifikuar me rritje buxheti për bursat e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional;

-Për të ngushtuar hendekun gjinor në arsimin profesional për vitin 2019 krahas rishikimit të kurrikulave me bazë gjinore, në vendimin e këshillit të ministrave për bursat tashmë do stimulohen me bursë dhe nxënëset (vajzat) që ndjekin drejtimet mesimore tipike për meshkuj (elektroteknikë, gjeodezi, termohidraulikë etj.);

-Gjithashtu shpenzimet korrente (për mallra e shërbime) do përdoren për praktikat profesionale të nxënësve.

Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2019 për arsimin e mesëm profesional, janë rritur me 10.7% më shumë se në 2018-ëm. Përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 6%. Buxheti i Arsimit në total përbën 3.3% GDP, nga ku shpenzimet për Arsimin profesional janë 0.19%. 0.6% e shpenzimeve totale të buxhetit 2019 i zë arsimit profesional.

Punësimi zë një vend të vecantë në planifikimin buxhetor. Për vitin 2019 i janë parashikuar fondet në vlerën 2,033 miliard lekë me një rritje prej 14% në krahasim me vitin 2018.

Politika e programit të punësimit janë: nxitja e mundësive për punë të denjë dhe rritja e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës si dhe nëpërmjet, përputhjes së kërkesës me ofertën për punë nga shërbimet e punësimit ku përfshihen: informacioni për vendet e lira të punës; ndërmjetësimi për punësim; këshillimi dhe orientimi për karrierë; programet e nxitjes së punësimit; mbështetjes me të ardhura për të papunët nëpërmjet pagesës së papunësisë; programet e formimit profesional dhe ofrimi formimit profesional cilësor. Për vitin 2018 janë miratuar 40,000,000 lekë për rikonstruksionin dhe organizimin e 15 zyrave të punësimit dhe për vitin 2019 janë planifikuar për këtë qëllim 58,000,000 lekë të cilat do të përdoren për rikonstruksion zyrave të punësimit.

Aktualisht 84,641,483 lekë janë akorduar për investimet në 12 zyrat e punësimit, të rikonstruara dhe organizuara, sipas modelit të ri të shërbimeve të punësimit, të cilat janë në proces.

Parashikimi i Shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime (602) në këtë program për vitin 2018 është 137,000,000 lekë dhe për vitin 2019 planifikimi është 160,000,000 lekë.

Gjatë diskutimeve në komision, deputetët, anëtar të këtij komisioni, bënë pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë rreth rikonstruksionit të shkollave profesionale, kualifikimit të mësuesve, zyrave të

punës, politikat dhe strategjitë e reja, politikat e të rinjve për punësimet e tyre, matësi i tregut të punës, etj.

Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Të ftuarit për të dhënë shpjegimë rreth buxhetit 2019, pasi paraqitën arritjet e deritanishme në fushën e rinisë, raportuan për synimet e tyre, si krijimin e Qendrave Rajonale Rinore në tre qytete të ndryshme të vendit si institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe programeve rinore, themelimi i Zyrës për Bashkëpunim Rajonal të të Rinjve për Ballkanin Perëndimor (ZRBR) dhe se do të zhvillojë dhe administrojë politika kombëtare në fushën e rinisë me qëllim përmirsimi i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, punësimin e të rinjve, arsimin profesional, praktikën mësimore, ngritjen e qendrave rinore, mbrojtjen e shëndetit të të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sociale kulturore dhe proceset vendimarrëse.

Gjatë prezantimit, u theksua vazhdimësia e zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Rininë për periudhën 2015-2020, i cili ka si qëllim zhvillimin dhe koordinimin e politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimarrëse.

Ministrja e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, e ftuar në këtë komision, shpjegoi Buxhetin i përcaktuar për programin e Rinisë për vitin 2019, i cili, për të mbuluar shpenzimet në programin e Sportit & Rinisë për periudhën 2019-2021 janë parashikuar 1.7 miliard lekë.

Vetëm për vitin 2019, buxheti i Sportit dhe Rinisë, është planifikuar në total 500 milion lekë, nga të cilat: 26,8 milion lekë janë shpenzime personeli për agjensitë e sportit & rinisë, nga të cilët, 223,2 milionë lekë janë shpenzime korrente/operative (602-606), dhe 250 milionë lekë janë shpenzime kapitale (230+231)

Fondet e planifikuara për programin e sportit dhe rinisë për vitin 2019 përfshijnë:

-1,28% të fondeve totale të MAS

-0,03% ndaj PBB-së

-0,10% ndaj shpenzimeve publike

Për vitin 2020 janë 566 milion lekë dhe për vitin 2021 janë parashikuar 650 milion lekë.

Anëtarët e komisionit drejtuan pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë në lidhje me aktet, politikat dhe strategjitë e reja për të rinjtë, qendrat rinore, të cilat duhet të përhapen në 62 bashkitë, kryesisht në zonat rurale të vendit, zbatimi i planit të veprimit për rininë, karta e të rinjve dhe funksionimi real i saj dhe problematika të tjera që shqetësojnë këtë grup.

Deputetët e opozitës, anëtar në këtë komision, nuk morën pjesë në mbledhjet për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin dhe ra dakord, që, raporti t'i dërgohet Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Zv. K R Y E T A R E

Elisa SPIROPALI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 22.11.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” (nen për nen)

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat
Seancës Plenare

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, organizoi me datë 14 Nëntor 2018 seancën dëgjimore me shoqërinë civile dhe me datë 21 Nëntor 2018 shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur kërkesave për shtesa apo ndryshime në buxhet të paraqitura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile ishin përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2019” është propozim i Këshillit të Ministrave bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa. Megjithatë, në kuadër të Buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u propozua nga kjo Ministri që në transfertën për FSDKSH të pakësohen 1 miliard lekë në programin e kujdesit parësor dhe të shtohet 1 miliard lekë në programin e kujdesit dytësor.

Projektbuxheti për vitin 2019 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë prezantimit të buxhetit të vitit 2019 përpara Komisionit deklaroi se buxheti i planifikuar për këtë ministri i mbulon të gjitha nevojat për programet buxhetore dhe për realizimin e programit politik qeverisës. Ky buxhet, për vitin 2019 parashikohet të jetë **75 miliard e 594 milion e 377 mijë lekë (përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën 13 miliard e 729 milion lekë) ose 4.31% i PBB ose 14.55% përkundrejt buxhetit të shtetit.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të fokusojë përmes këtij buxheti:

- ✓ Financimin universal për kontrollin bazë mjekësor për grupmoshën 35 – 70 vjeç, vizitat tek mjeku i familjes, rimbursimin e barnave, vizitat dhe ekzaminimet tek mjeku specialist sipas hallkave të sistemit të referimit për të gjithë popullsinë rezidente në vend;
- ✓ Financimin e shërbimit të urgjencës mjekësore 24/7 në territor të shpejtë, të fuqizuar dhe më të specializuar;
- ✓ Mbulimin e shpenzimeve të sistemit parësor dhe atij spitalor;
- ✓ Rikonstruksionin tërësor dhe pajisjen e rreth 100 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin me vlerë 300 milion lekë;
- ✓ Financimi në vazhdim të projektit për modernizimin radikal të QSUT në shërbimet e kirurgjisë së përgjithshme me një vlerë totale investimi 8.52 milion euro dhe ndërtimin e një spitali të ri modern të sëmundjeve të brendshme 14.28 milion euro, si dhe fillimin e punimeve për spitalin modern të pediatriisë me vlerë totale 8 milion euro;
- ✓ Financimin e rikonstruksioneve, ndërtimeve të reja dhe kompletimin me pajisje mjekësore në disa spitale rajonale si Rikonstruksionin dhe shtesën në Maternitetin e Lezhës, Rikonstruksionin dhe shtesë për Maternitetin e Beratit me vlerë 375 milion lekë si dhe garantimin përfundimtar të investimeve të nisura gjatë vitit 2018;
- ✓ Financimin e rritjes së pagave të 18,416 mjekëve dhe infermierëve, nga i cili do të përfitojnë 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë;
- ✓ Financimin me 4.7 miliardë lekë të skemës së re të ndihmës ekonomike, e cila garanton efikasitetin, transparencën, barazinë sociale, gjithëpërfshirjen, duke shmangur abuzivitetin, subjektivizmin njëkohësisht duke u alternuar me skemen e punësimit;
- ✓ Financimin me 15.8 miliard lekë të gjithë skemës së pagesave të personave me aftësi të kufizuara dhe rrjetin e shërbimeve sociale në të gjithë vendin;

Buxheti i vitit 2019 do të mundësojë zbatimin e skemës së re të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara sipas modelit bio-psiko-social me qëllim rritjen e numrit të përfituesve të aftësisë së kufizuar dhe kujdestarëve të tyre me në fokus krijimin e një sistemi shërbimesh integruese të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesit social si dhe do të garantojë zbatimin e skemës së re të vlerësimit dhe programeve të ri-integrimit social me qëllim reduktimin e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe përfshirjes së tyre në tregun e punës.

Në lidhje me Mbrojtjen Sociale, Ministria synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndihma Ekonomike;

Paaftësia e Kufizuar; dhe Shërbimet Sociale. Risi do të jetë mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2019-2021, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen rreth 600 persona të trajtuar më parë me Ndihmë Ekonomike (NE) dhe pagesë të Aftësisë së Kufizuar. Gjithashtu, krijimi i fondit social synon mbështetjen e njërive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të Ndihmës Ekonomike me paketa sociale shëndetësore.

Për të mbuluar shpenzimet në **programin e Sportit dhe Rinisë për periudhën 2019-2021** janë parashikuar 1.7 miliard lekë nga të cilat:

- ✓ për vitin 2019 janë parashikuar 500 milion lekë;
- ✓ për vitin 2020 janë 566 milion lekë;
- ✓ për vitin 2021 janë parashikuar 650 milion lekë;

Për vitin 2019, buxheti i Sportit dhe Rinisë, është planifikuar në total 500 milion lekë, nga të cilat:

- ✓ 26,8 milion lekë janë shpenzime personeli për agjensitë e Sportit & Rinisë;
- ✓ 223,2 milionë lekë janë shpenzime korrente/operative (602-606);
- ✓ 250 milionë lekë janë shpenzime kapitale (230-231);

Fondet e planifikuara për programin e sportit dhe rinisë për vitin 2019 përfshijnë:

- ✓ 1,28% të fondeve totale të MAS;
- ✓ 0,03% ndaj PBB-së;
- ✓ 0,10% ndaj shpenzimeve publike;

Për zhvillimin e sportit, prioritar është ndërtimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës sportive sidomos të terreneve sportive në mjediset shkollore si dhe ambjentëve sportive ku zhvillohet një numër i madh i disiplinave sportive.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave si priorite të fushës së punësimit për vitin 2019 ka shprehur:

- ✓ Modernizimin e shërbimeve publike të punësimit, rritjen e punësimit të grave, të rinjve dhe personave vulnerabël.

- ✓ Hartimin e politikave dhe programeve, që promovojnë punësim cilësor, duke rritur kërkesën për punë, duke nxitur produktivitetin dhe punësueshmërinë;
- ✓ Uljen e papunësisë dhe pasivitetit të lartë, veçanërisht në grupin e të rinjve dhe grave;
- ✓ Zbatimin e Modelit Kombëtar të Punësimit (Modeli i ri i shërbimeve) në 36 zyrat e punësimit, përmes riorganizimit të ambienteve të punës, sipas modelit të ri të shërbimeve të punësimit në tre nivele; ngritjes së sistemit të menaxhimit të performacës të shërbimeve dhe modernizimit të infrastrukturës dhe sistemeve IT në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- ✓ Riorganizimin e zyrave të mbetura të punësimit të papërfunduara në vitin 2018;
- ✓ Zhvillimin e burimeve njerëzore;

Për vitin 2019, modeli i ri i shërbimit do të zbatohet në 36 zyra punësimi, të shoqëruar me trajnimin e stafit. Miratimi i ligjit të ri për nxitjen e punësimit dhe programeve të reja dhe të rishikuara për nxitjen e punësimit, do të synojnë mbështetjen e grupeve më vulnerabël dhe rritjen e punëkërkesve të papunë, që përfitojnë nga këto programe si dhe shqyrtimi i mundësive të zgjerimit të mbulimit të shërbimeve në zonat rurale në bashkëpunim me qeverinë lokale.

Shoqëria Civile në dëgjesën e takimit të datës 14 Nëntor ngriti një sërë argumentash në lidhje me kërkesat e tyre për rritjen e buxhetit të vitit 2019 në lidhje me fushat prioritare që ndikojnë drejtpërdrejtë aftësinë e tyre integruese në jetën sociale dhe ekonomike. Përfaqësues të saj ishin nga Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, Shoqata e Invalidëve të Punës, Shoqata e të Verbërve, Save the Children, Universiteti i Mjeksisë të Tiranës, AWEN-rrjtej i fuqizimit të gruas në Shqipëri, Fondacioni Down Syndrome Albania, si dhe shoqata “Ndihmoni Jetën”.

Pasi dëgjoi dhe diskutoi mbi propozimet konkrete të bëra nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, Komisioni ra dakord që t’i rekomandojë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, që të vlerësojë mundësinë e përjashtimit nga pagesat/taksat e projektbuxhetit të vitit 2019 të:

- Organizatave jofitimprurëse dhe të ngjashmeve, nga barra që i shkaktajnë taksat në ato që në mënyrë të vecantë lidhen me pagesat për ndërtesën dhe truallin;
- Organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për grupet në nevojë nga pagesat si biznese për energjinë elektrike dhe pagesat për ujin e pijshëm;

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin për buxhetin e vitit 2019.

Anëtarët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhjen e Komisionit.

Zv. Kryetare

Elisa SPIROPALI